



Masa në kuadër të parandalimit të përhapjes së sëmundjes infektive të *COVID-19* janë ndërmarrë edhe në fushën e sistemit gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ("**KLGJ**") me anë të vendimit nr. 127, datë 10.03.2020 ("**Vendimi**") ka vendosur pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm në të gjitha gjykatat e vendit për një periudhë **2 javore**.

Përfundimisht nga ky rregull do të bëjnë rastet e:

- Veprimeve dhe shërbimeve gjyqësore që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme, të vlerësuara si të tilla rast pas rasti nga gjyqtari;
- Seancat e vlerësimit të masave të sigurisë,
- Seancat në të cilat janë kërkuar ose zbatuar masat e sigurisë me burg, dhe kur të arrestuarit, të pandehurit, ose mbrojtësit e tyre e kërkojnë shprehimisht që të vijohet me shqyrtimin e tyre.

Sipas këtij Vendimi, gjykata në çdo rast duhet të shmangë praninë e publikut në zhvillimin e seancave gjyqësore.

Për më tepër, bazuar në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare në datën 12.03.2020, KLGJ ka marrë edhe masa të tjera organizative duke pezulluar deri në një njoftim të dytë:

- Organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve plenare;
- Pezullimin e të gjitha afateve të parashikuara në shpalljet publike të bëra nga KLGJ;
- Pezullimin e afateve në procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të gjyqtarëve.

Gjithashtu, në kuadër të zhvillimeve të tjera në fushën gjyqësore KLGJ bën me dije se me datë 11.03.2020 janë dekretuar nga Presidenti i Republikës tre anëtarë të rinj të Gjykatës së Lartë së Republikës së Shqipërisë.



Measures to prevent the spread of *COVID-19* infectious disease have also been taken for the judiciary system.

The High Judicial Council (“**HJC**”) by decision no. 127, dated 10.03.2020 (the “**Decision**”) has ordered the suspension of the activity and judicial services in all courts of general and special jurisdiction, in the whole country for a period of **2 weeks**.

Exception to this rule shall be the following cases:

- Judicial actions and services related to matters of a urgent nature, assessed as such on a case-by-case basis by the judge;
- Hearings regarding the assessment of security measures;
- Hearings at which arrest security measures are sought or enforced, and where the detainees, defendants, or their defense attorney expressly request to proceed with the examination.

According to this Decision, the court should in any case avoid the public presence during court hearings.

In addition, based on the notice published on the official website on 12.03.2020, HJC has taken some additional organizational measures by suspending until a second notice:

- The organization and holding of plenary meetings;
- All deadlines regarding public announcements made by the HJC;
- Deadlines in the procedures of verification of the conditions and legal criteria for the recruitment of judges.

In the context of other developments in the judicial field, the HCJ notes that on 11.03.2020 the President has decreed three new members of the Supreme Court of the Republic of Albania.